

PAKETË INFORMUESE PËR TË RINJTË

Të krijosh dhe pasurosh portofolin e karrierës

2



PUNËSIMI DHE MIGRIMI I TË RINJVE

Përfitimi i Dobive dhe Pakësimi i Rreziqeve

MDG i F
MDG ACHIEVEMENT FUND



United Nations
ALBANIA

Zhvillimi i karrierës është një rrugëtim i gjatë, një proces i vazhdueshëm, i cili duhet të ndihmojë të rinjtë, por edhe cdo individ në cdo moshë dhe kohë të organizojë dijet dhe t'i përdorë ato në mënyrë efikase për të njohur botën e punës dhe për të zënë me sukses vendin e tij në këtë botë.

Kjo paketë informative synon të përgatisë të rinjtë të hyjnë në tregun e punës. Hapa të rëndësishëm si vlerësimi i vetes, krijimi dhe pasurimi i portofolit personal të karrierës, shkrimi i një curriculum, aplikimi për një vend pune, do të jenë objektet e paketës informative, dhe një pjesë e rëndësishme e këshillimit të personelit të zyrës rajonale të punësimit.

Pjesë shumë e rëndësishme e përgatitjes së të riut për të hyrë në tregun e punës, është të vlerësojë dhe dokumentojë aftësitë dhe përvojat e tij personale duke krijuar portofolin e karrierës. Objekti i kësaj broshure është pikërisht krijimi dhe pasurimi i portofolit personal të karrierës.

Deri vonë, portofoli apo dosja personale është përdorur vetëm për dhe nga profesionet krijuese apo artistike. Sot, pothuajse të gjithë punëmarrësit nisin gjykimin për kandidatin për punë nga një portofol mirë i organizuar. E ku ka provë më të mirë për aftësitë tuaja të shkrimit, paraqitjes dhe organizimit?

Përgatitja për tregun e punës nuk është e plotë nëse i riu nuk ka një portofol karriere të mirë.

Pse duhet të kem një portofol karriere?

Portofoli personal i karrierës është një mënyrë shumë e mirë për të organizuar dhe paraqitur qartë dhe në mënyrë pozitive përvojat, kualifikimet, dhe aspiratat tuaja. Pasja e një portofoli të gatshëm, ju ndihmon ta bëni më shpejt dhe më lehtë një aplikim për një vend pune, apo për një kurs profesional. Mbi të gjitha një portofol personal, ju ndihmon të dokumentoni dhe organizoni rrugëtimin dhe përvojat tuaja, si dhe ju ndihmon të vendosni objektiva të qarta për të ardhmen.

Portofoli i karrierës mund të ndërtohet me ndihmën e këshilluesit të karrierës në

zyrën rajonale të Punësimit. Kërkoni për këshilluesin e karrierës për të rinj, bisedoni me të dhe filloni të krijoni portofolin tuaj. Gjithashtu, në shkollën e mesme në lëndën e këshillimit të karrierës, ka njohuri dhe këshilla praktike për portofolin e karrierës.





Si ta krijoj?

Ju duhet vetëm një dosje kartoni, madje edhe një karton i thjeshtë i palosur më dysh, të gjitha çertifikatat apo dokumenta të tjera që lidhen me arsimimin, apo punësimin tuaj dhe pak fantazi e aftësi krijuese.

Është e rëndësishme që portofoli juaj të jetë vizualisht i paraqitshëm, i pasur në përmbajtje, por edhe i lehtë për t'u lexuar. Kujtoni se libri nuk gjykohej vetëm nga koptina, por edhe nga mënyra e paraqitjes dhe shkrimit të faqeve të brendshme. Për më tepër, punëdhënësi kur shqyrton dosjen tuaj personale nuk numëron thjesht çertifikatat, por vlerëson edhe aftësitë tuaja krijuese dhe dëshirën për t'u paraqitur sa më mirë.

Krijoni një faqe të parë, në të cilën të vini emrin, moshën, ndoshta një foto tuajën. Faqja mund të ketë një sfond me ngjyrë,

dhe mund të jetë e vizatuar apo e krijuar me kompjuter.

Si të vendos se çfarë duhet të përfshij në portofolin tim?

Kur zgjedh çfarë të përfshij në portofolin tënd, mendo për qëllimin dhe se sa vlerë ka ajo që do të përfshij për të komunikuar mesazhin tuaj. Dokumentat duhet të jenë të përshtatshme për objektivin e karrierës tuaj dhe duhet t'i dëshmojnë atij që e lexon se kush jeni dhe çfarë aftësish keni.

Mos e teproni, përqandrohuni tek aftësitë që janë të rëndësishme për tregun e punës. Nga ana tjetër, mos nënvlerësoni asnjë përvojë, edhe punën më të shkurtër, apo të thjeshtë.

Gjithmonë rilexojeni dhe rirregulloni portofolin tuaj.

Përmbajtja e portofolit

Tani që vendosët për paraqitjen e portofolit tuaj, filloni dhe mendoni për përmbajtjen e tij. Portofoli juaj duhet t'i ngjajë një dosje me disa seksione, të cilat mund të titullohen:

1. **Përmbajtja**
2. **Curriculum Vitae**
3. **Aftësitë bazë**
4. **Aftësi të tjera/Cilësi personale**
5. **Përvoja e punës**

Në një broshurë të veçantë, pjesë e kësaj pakete informative, ju do të mësoni gjithshka rreth një curriculum vitae, Pasi ta keni hartuar dhe kështilluar atë me një mik, prind, apo kështilluesin e karrierës, vendoseni atë në dosje.

Sic e shihni, një portofol karriere është shumë më tepër se sa një curriculum i shkruar mirë. Një pjesë të mirë të dosjes tuaj, do ta zënë aftësitë tuaja bazë, aftësitë për jetën dhe cilësitë personale.

Punëdhënësit janë të interesuar të dinë mbi të gjitha çfarë aftësish dhe cilësish personale ka individi që ata do të marrin në punë dhe do ta bëjnë pjesë të ekipit të tyre. Nga ana tjetër, gjetja dhe renditja e aftësive më të rëndësishme personale, është një ushtrim shumë i mirë përgatitor për ju. Ju do të kuptoni cilat janë pikat tuaja të forta, cilat janë ato që kanë nevojë të përmirësohen e të forcohen. Kjo ju ndihmon të kuptoni edhe për çfarë kursesh kualifikimi keni nevojë.

Studime të shumta mbi punëdhënësit, kanë treguar se mbi të gjitha ata duan të marrin në punë, punonjës që:

- arrijnë të komunikojnë mirë me të tjerët dhe të thonë atë që mendojnë

- dinë të zgjidhin problemet
- punojnë mirë me të tjerët, por edhe në mënyrë të pavarur
- **dhe mbi të gjitha janë të përgjegjshëm.**

Kjo vlen sidomos për të rinjtë, të cilët për shkak të moshës, kanë pak përvojë pune. Gjykimi kryesor i punëdhënësve do të bazohet mbi cilësitë tuaja, dhe mënyrën se si ju i paraqisni ato.

Dhe seksioni i fundit, por shumë i rëndësishëm, do të jetë për përvojat e punës; dhe me përvoja pune kemi parasysh çdo lloj pune: punë e gjatë, apo e shkurtër, e paguar, ose vullnetare, përfshirë edhe aktivitetet pune në shtëpi, familje, apo komunitet.

Kujdes, sigurisht që ju do të rendisni përvojat e punës edhe në Curriculum Vitae; dhe kjo nuk është thjesht një përsëritje. Në seksionin e dosjes personale, ju do të përfshini çdo lloj dokumenti, apo prove që lidhet me përvojat e punës.





Mbushni seksionet

Tani që e keni ndarë portofolin në seksione, duhet t'i mbushni ato. Çfarë dokumentash do të përfshini, apo çfarë do të shkruani e paraqisni në secilin seksion.

PËRMBAJTJA:

Kjo faqe do të krijohet në fund dhe do të ketë formën dhe pamjen e përmbajtjes së një libri.

CURRICULUM VITAE

Ju do të shkruani Curriculum Vitae, sipas këshillave që do të gjeni në broshurën përkatëse. Përpara se t'i jepni një formë përfundimtare, këshillohuni me këshilluesin e karrierës në zyrën rajonale të punësimit.

AFTËSITË BAZË

Portofoli juaj duhet të tregojë se ju keni aftësitë bazë të mëposhtme

- aftësi komunikimi (të folurit, të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit)
- aftësitë matematikore
- njohuri në shkenca dhe teknologji

Për të provuar se ju i zotëroni këto aftësi, ju duhet të përfshini në portofolin tuaj.

Një kopje zyrtare të dëftesës së shkollës, klasës më të fundit

Letra pranimit nga shkolla, apo kurse.

Letra që vërtetojnë bursa në se keni marrë

Ndonjë test gjuhe, kompjuteri, apo diplomë olimpiade

Çdo certifikatë që keni marrë në shkollë për ndonjë lëndë

Shembuj të dickaje që keni shkruar (një ese interesante, artikull në gazetën e shkollës, poezi, etj.)

Certifikata të ndonjë kursi të shkurtër (për shembull ABCS+)

Përmbledhje të ndonjë projekti që mund të keni bërë në shkollë (për shembull ndërtimi i qarkut elektrik në fizikë)

Është një mundësi që ju të tregoni arritjet tuaja akademike, cdo gjë për të cilën ju jeni krenar. Ju ndoshta mund të mos keni patur nota të mira në matematikë, e fizikë, por keni ndërtuar vetë me mjete rrethimore një qark të thjeshtë elektrik, apo mund të jeni krenaria e shtëpisë për të rregulluar të gjitha elektroshtëpiaket.

AFTËSITË PËR JETËN

Aftësitë për jetën janë në fakt një grup aftësish psikosociale që bëjnë që individit të komunikojë, të përballojë dhe të marrë vendime të peshuara në çdo lloj situatë. Cilat nga këto aftësi janë të rëndësishme për të përballuar me sukses tregun e punës.

- ▶ Aftësi të të mësuarit
- ▶ Aftësi të të arsyetuarit
- ▶ Aftësi të mendimit krijues
- ▶ Aftësi të vendimmarrjes
- ▶ Aftësi për të zgjidhur problemet

Duket e vështirë të dokumentosh gjëra të tilla, apo jo? Në fakt, jo sq shumë. Këtu është vendi që ju në mënyrë të përmblendhur, vërtetë shkurt, por edhe qartë të flisni për shembuj konkretë nga jeta juaj ku ju keni treguar cilësitë e mësipërme. Shembujt mund të jenë në shkollë, në familje, me miqtë, apo edhe në një vend ku keni punuar më parë.

Merrni letra rekomandimi të mësuesve tuaj apo njerëzve të rëndësishëm në komunitetin tuaj, të cilët gjithashtu dëshmojnë dhe tregojnë me shembuj se ju keni cilësi të tilla.

Ju vetë mund të përfshini edhe faqe interneti që mund të keni krijuar, planin e një aktiviteti të cilin keni ndihmuar të organizohet, fletëpalosje, lajmërimi, ftesa për aktivitete sociale që i keni krijuar vetë. Çdo gjë që keni krijuar vetë, apo në bashkëpunim me miqtë dhe që tregon se ju keni aftësitë e mësipërme.



CILËSITË PERSONALE

Punëdhënësi po kërkon sigurisht një individ që të ketë cilësitë teknike që i duhet për të kryer punën, por mbi të gjitha ai po punëson dhe po bën pjesë të ekipit të tij një njeri, prandaj do të sigurohet:

- ▶ që jeni i përgjegjshëm
- ▶ që keni besim tek vetja
- ▶ që keni aftësi të mira sociale
- ▶ që jeni i ndershëm
- ▶ që ruani integritetin
- ▶ që përshtateni lehtë
- ▶ që mund të jeni i pavarur
- ▶ që jeni gjithmonë korrekt
- ▶ që jeni i motivuar dhe

bashkëpunues

- ▶ që kur punoni, bëni përpjekjet maksimale për të arritur rezultatet e kërkuara

- ▶ që dini si ta organizoni dhe përdorni mirë kohën

Të gjitha këto janë cilësi shumë të rëndësishme.



sishme për një qytetar, anëtar komuniteti, por edhe për një punonjës. Në se dëshmon se ke cilësi të tilla, punëdhënësi sigurohet që ti je në gjendje të punosh mirë me shokët, të sillesh në mënyrë të përgjegjshme dhe të marrësh vendime të drejta në vendin e punës, të përshtatesh, të përballosh presionin, por edhe të jesh i motivuar dhe të kesh rendiment në punë.

Për të dëshmuar se keni disa prej këtyre cilësive, shkruani përsëri shkurt për shembuj si:

- **Plotësimi** i një projekti në afatin e duhur, sidomos në kushte të vështira;
- **Pjesëmarrja** në një grupim, apo organizatë komunitare është një provë shumë e mire;
- **Ndonjë post** që mund të keni pasur (përfaqësues i qeverisë së nxënësve, apo parlamentit rinor);
- **Një shembull** në se keni ditur të zgjidhni një konflikt në shkollë;
- **Dhe rekomandime** nga mësues, apo punëdhënësi të mëparshëm, qoftë edhe informalë.

PËRVOJAT E PUNËS

Deri tani keni treguar të gjitha cilësitë tuaja në përpjekjen për të siguruar punëdhënësin që jeni një i ri qytetar i përgjegjshëm dhe i denjë; tani duhet të tregoni **PËRVOJËN TUAJ**, pra atë që dini të bëni. Cfarëdo lloj pune që të keni bërë, të shkurtër, apo të gjatë, të paguar, apo të papaguar, mos nënvlerësoni asnjë përvojë, pasi secila prej tyre ju ka dhënë aftësi dhe ka krijuar gatishmërinë tuaj për tregun e punës.

Gjithashtu kujtoni edhe që puna e paguar përfshin: mbajtjen e fëmijëve, pastrimin e shtëpive, rregullimin e oborreve, korrijen apo vjeljen e frutave, peshkimin, kujdesin për kafshët shtëpiake, etj. Ndërkohë që ju i keni renditur përvojat e punës në CV-në tuaj, në këtë seksion, ju do të përfshini provat e këtyre përvojave, si për shembull:

- Vërtetim, apo letër rekomandimi nga një punëdhënësi
 - Një kartëvizitë e thjeshtë e punëdhënësit tuaj, ndonjë kopje të vlerësimit të punës në se keni
 - Një listë të aftësive që keni fituar nga puna si: puna në grup, menaxhimi i mirë i kohës, puna me klientët, etj.
- Përshkrim i projekteve/detyrave që ju keni kryer
- Letra rekomandimi nga kolegët tuaj
- Foto tuajat ndërkohë që punoni
 - Çdo shembull të punëve vullnetare në shkollë, familje, kishë, komunitet.
 - Çdo shembull të punëve, apo aktiviteteve familjare, qoftë brenda shtëpisë, qoftë edhe në bujqësi, blegtori, apo ndihmë me aktivitete të vogla tregtare.



“Punësimi dhe Migrimi i të Rinjve”, është një program i qeverisë shqiptare në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara, financuar nga qeveria spanjolle.

- *Secili nga ne bëhet diçka apo dikushi në jetë, dhe kemi mundësi ta zgjedhim vetë.*
- *Gjetja e një pune është vetëm pikënisja e një rrugëtimi të gjatë.*
- *Këshillimi duhet të ndihmojë të rinjtë të marrin vetë vendimin e duhur në përputhje me moshën, dijet, aftësitë dhe tregun aktual të punës.*
- *Roli parësor i shërbimeve të punësimit për të rinj është të ndihmojë të rinjtë të përputhin jetën me karrierën dhe profesionin e zgjedhur.*

PUNËSIMI DHE MIGRIMI I TË RINJVE

Përfitimi i Dobive dhe Pakësimi i Rreziqeve

MDG i F
MDG ACHIEVEMENT FUND



United Nations
ALBANIA